

NATURA 2000

Për natyrën

Për njerëzit



Pyetje dhe përgjigje për rajonet e Natura 2000



“Përforcimi i kapaciteteve për zbatimin efektiv të legjislacionit evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës”




Për pyetje kontaktoni në info@natura2000.gov.mk

Ky botim është punuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e këtij punimi përgjegjës janë vetëm Sektori për natyrë i MMJPH, SYKE ose konzorciumi dhe i njëjti jo domosdoshmërisht reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Autorët e fotografive: Përfaqësues të Metsahalitus nga Finlanda dhe Shërbimi shtetëror për rajonet e mbrojtura në Lituani.



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



Natura 2000 është rrjetë i rajoneve të mbrojtura ku janë të përfshira vendbanimet dhe llojet më të rëndësishme dhe më të rrezikuara në 28 vende anëtare të Bashkimit Evropian. Ky është rrjeti më i madh i kordinuar për rajonet e mbrojtura në tokë dhe ujë. Rajonet e Natura 2000 emrohen ose përcaktohen në përputhje me Direktivën për vendbanime dhe Direktivën për shpendë.

Qasja për mbrojtjen e natyrës në kornizat e Natura 2000 është e gjërë dhe parimisht përqendrohet te njeriu, i cili punon për natyrën dhe jeton në harmoni me natyrën. Por, me rëndësi është që vendet anëtare të sigurohen që rajonet udhëhiqen ose menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme.



Mësoni më shumë për Natura 2000
<http://natura2000.eea.europa.eu/#>



Mësoni më shumë për:
<http://natura2000.gov.mk/>

Për pyetje kontaktoni në info@natura2000.gov.mk

Observatori

Një numër i madh vizitorëve pa dyshim kanë dashur të dinë se sa është emocionuese të shihet ndonjë rajon nga lartë. Tani kjo është e mundur me 24 pika vrojtimi të reja në rajonet e mbrojtura, të larta mbi 15 m. Ngjitja te secila prej tyre është një ndjenjë e veçantë dhe ofron pamje dhe emocione të ndryshëm sepse secila prej tyre gjendet në ekosistem të ndryshëm.



Observatori në qarkun Kamanai, rezervat i rreptë natyror me pamje peizazhi të moçaleve dhe ishujve Kamanos, të rrethuar me pyje (Lituani)

Menaxhimi me rajonet e Natura 2000

Me mbështetjen nga fondet e BE-së u realizuan më shumë se 20 projekte teknike për rikonstruimin e regjimit të ujit në rajonet e Natura 2000.



Është restauruar regjimi i ujit natyror në vendet e rëndësishme për mbrojtjen e moçaleve dhe vendbanimeve pylllore moçalike.



Livadhet dhe livadhet ujore janë të kositura dhe të renovuara pranë tokës së punuar bujqësore. U kosit dhe u largua kallami dhe vegetacioni tjetër i padëshiruar.



Pas mbarimit të kullotjes së bagëtisë, largohet vegetacioni jo cilësor, e cila është masë për menaxhimin e zonave të mbrojtura të Natura 2000, në rajonin për mbrojtje të vendbanimeve.



Sporti për hapësirë të hapur si burim i shëndetit dhe mirëqenies

Natyrë është burim i shëndetit dhe mirëqenies. „Metsähallitus“ bashkërisht me partnerët e saj i promovon efektet pozitive të aktiviteteve në hapësirë duke ju ofruar alpinistëve shërbime të volitshme, si shtegje, vende për zjarr fushimi, udhëregues, harta dhe të dhëna për destinacionet më të bukura nga natyra e Finlandës.

Shkenctarisht është dëshmuar se natyra e përmirëson shëndetin dhe mirëqenien tone së paku në tri mënyra:

- Në hapësirë, aktiviteti fizik rritet.
- Natyra revitalizon dhe e redukton stresin.
- Aktivitetet në natyrë e përmirësojnë socializimin dhe ndjenjën e përkatësisë ndaj bashkësisë.

Në Finlandë, zonat e mbrojtura dhe vendet për aplinizëm gjenerojnë të ardhura për biznesin lokal

Biznesi lokal ka përfitime ose dobi nga mjetet të cilat Qeveria e Finlandës ua alokon parqeve nacionale dhe vendeve për alpinizëm, sepse mjetet kthehen në shoqëri disa here, me anë të ndërmarrjeve lokale dhe punësimeve. Mjetet nga buxheti shtetëror përdoren për ndërtimin e infrastruktures alpiniste në zonat e mbrojtura (përfshirë këtu edhe zonat e Natura 2000). Nga ana tjetër, sektori privat zhvillon shërbime turistike rreth këtyre rajoneve.



Çfarë është dallimi mes rajonit të mbrojtur dhe rajonit të Natura 2000?

Qëllimi i instalimit të rrejtit Natura 2000 është të mbrohen rajonet që posedojnë vlerë të madhe natyrore për mbrojtjen e vendbanimeve dhe llojeve, të cekura në Direktivën për vendbanime dhe Direktivën për shpendë. Këto lloje janë me rëndësi të veçantë për BE sepse janë të rrezikuara, të cenueshme, të rralla dhe endemike, ose janë shembuj jashtëzakonisht tipik për një ose më shumë prej gjithsej nëntë rajoneve evropiane biogeografike.

Rezervatet natyrore, parqet nacionale dhe llojet tjera të rajoneve mbrojtëse përcaktohen në përputhje me Ligjin. Deklarimi ose emrimi mund të ndodh për shumë arsye, dhe mund të ketë të bëjë me vendbanimet dhe llojet të cilët janë jashtë atyre të përfshira në rrejtën Natura 2000.

Rajonet e mbrojtura nacionale, poashtu mund të shpallen edhe si rajone të Natura 2000, sepse në këto rajone ekzistojnë vendbanime dhe lloje të cilat, poashtu janë edhe me rëndësi evropiane.



A mund të gjithë rajonet e Natura 2000 të bëhen rajone të mbrojtura në nivel nacional?

Më shpesh, kërkesa e vetme e BE është që vendbanimet dhe llojet që janë të rëndësishme për BE të mbrohen në nivel të statusit të volitshëm mbrojtës, me ndihmën e njeriut, si për shembull, bujqësia tradicionale. Andaj, deklarimi ose shpallja e ndonjë rajoni si rajon me rëndësi të veçantë për mbrojtje, nuk do të thotë se aktivitetet aktuale në atë vend do të duhet të ndryshojnë ose të ndërpriten.

Vendet anëtare kanë të drejtë të vendosin, në cilën mënyrë do të menaxhojnë dhe si do ta mirëmbajnë rajonin. Kjo mund të rregullohet me ligj, por jo domosdoshmërisht (për shembull, të shpallet rezervat natyror, përmendore në natyrë, park nacionale, etj.), megjithatë mund të rregullohet edhe me marrëveshje (për shembull, me firmosjen e një marrëveshjeje për menaxhim me pronarët e tokës).

Mirëmbajtja e vendbanimeve dhe llojeve në status të volitshëm konservues jo gjithmonë bie ndesh me aktivitetet e njeriut. Përkundrazi, ndonjëherë aktivitetet e njeriut janë të nevojshme për mirëmbajtjen e vendbanimeve dhe llojeve gjysmënatyrore, përfshirë këtu gjuetinë dhe peshkimin e kontrolluar.

A NDIKON NATURA 2000 TE AKTIVITETET NË PRONËN TIME?

Nëse tashmë zhvilloni aktivitete në ndonjë rajon, i cili më vonë shpallet për Natura 2000, mos keni frikë se diçka do të ndryshoj. Shpallja e Natura 2000 nuk do të thotë se në atë rajon duhet të pushojnë të gjithë aktivitetet. Në disa raste mund të nevojiten disa ndryshime ose përshtatje të aktiviteteve që të mbrohen vendbanimet dhe llojet për të cilët është shpallur mbrojtja e rajonit, ose të ndihmohet që të njëjtit të kthehen statusi i mirë i mbrojtjes. Por, në disa raste tjera aktivitetet ekzistuese do të vazhdojnë si zakonisht.

Gjegjësisht, në shumë rajone, vendbanimet dhe llojet që janë të pranishme atje kryesisht janë të varura nga vazhdimësia e aktiviteteve të tilla për mbijetesën e tyre afatgjate, andaj në raste të tilla, me rëndësi është të gjenden mënyra të mbështeten dhe, sipas nevojës, të përfordohen aktivitetet e tilla siç janë për shembull kullotjet ose krasitjet e rregullta të kaçubeve.



Kullotja e dhenëve me pronar privat që të ruhen shpatet e hapura të Parkut Nacional Aukshtatia, si rajon i Natura 2000 (Lituan)

A MENAXHOHEN PYJET NË NATURA 2000 VETËM ME QËLLIM TË KONZERVIMIT?

Jo, pyjet në Natura 2000 mund të menaxhohen për qëllime dhe funksione të ndryshme, gjegjësisht, përveç qëllimeve për mbrojtje të natyrës, ata mund të menaxhohen edhe për shkak të prodhimit të drurit, gjuetisë, rekreacionit, etj. Por, menaxhimi me pyjet në rajonet e Natura 2000 patjetër gjithmonë të jetë në përputhje me qëllimet specifike të mbrojtjes së natyrës dhe në mënyrë aktive të kontriboj në këtë drejtim. Atje ku rajoni në Natura 2000 gërshetohet me ndonjë rezervat natyror ose park nacional, pyjet më shpesh menaxhohen për qëllime mbrojtëse, sipas ligjit aktual nacional. [Menaxhimi efektiv me rajonet e Natura 2000 nënkupton bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve relevante për mbrojtjen e natyrës dhe për pylltari, këshilltarëve privat dhe publik për pyje, palëve tjera të përfshira dhe organizatave joqeveritare.](#) Prandaj, shumë është me rëndësi që të njëjtët të arrijnë marrëveshje mes tyre, marrëveshje e cila do të jetë e volitshme dhe do të ec në drejtim të plotësisht të të drejtave dhe interesave ligjore të palëve të përfshira.



Begatitë e pyjeve

Kokërrat rritet natyrshëm në pyjet e egra në Finland, një nga mjediset më të pastërta në botë.

A JEPET NDIHMË FINANCIARE PËR MENAXHIMIN E NATURA2000?

Rrjeti i Natura 2000 është gurthemel i politikave për avancimin e diversitetit biologjik në Bashkimin Evropian. Por, ashtu si rajonet tjera të mbrojtura, rrjeti Natura 2000 ka nevojë për financim që t'i realizoj qëllimet e saj.

Kërkesat për menaxhimin e Natura 2000 janë integruar në shumë burime të financimit të BE, siç janë fondet e strukturuar të (ERDF), fondi për zhvillim (EAFRD), fondi Evropian për peshkim (EMFF), Programi i Unionit (LIFE), etj. Gjithsesi, pritet edhe nga vendet anëtare të kontribuojnë në finalizimin e masave.

Programi Lajf -LIFE është programë e vetme, evropiane që synon financimin e projekteve në fushën e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen e natyrës në vendet e BE (por edhe në vendet kandidate për BE, vendet në proceset drejtë anëtarimit në BE dhe në vendet fiqnje). Projektet e realizuara nën ombrellën e kësaj programe i arrijnë rezultatet e pritura nga mjetet e investuara, sigurojnë dhe hapin vende pune, ndihmojnë me projekte inovative nëpër BE, dhe përfundojnë me rezultatet të kënaqshme, konkrete.



Projekt i integruar LIFE në Lituani
"Optimizimi i menaxhimit me rrejtin e Natura 2000 në Lituani"

MUNDËSI PËR FINANCIM PËR NATURA 2000

Prej vitit 1992 nëpërmjet programës LIFE janë financuar rreth 4171 projekte, përmjet të cilëve janë shfrytëzuar rreth 3,4 miliardë euro për mbrojtje të mjedisit dhe klimës.

Lajme të mira për mbrojtjen e vlerave natyrore!
Financimi i rajoneve të Natura 2000 është afatgjatë.

Mësoni më shumë për mundësitë për financim të Natura 2000



A MUND TË UDHËTOJ NË RAJONIN E NATURA 2000?

Njerëzit shkojnë në natyrë për arsye të ndryshme. Shumë prej tyre për t'u relaksuar me pejzazhin e saj të qetë dhe të heshtur, disa tjerë pëlqejnë të shohin fusha të reja, kurse disa tjerë adhurojnë aktivitetet në natyrë, si notimin, ecjen, biçiklizmin, peshkimin, gjuetinë, etj. Pavarisht motivit, Natura 2000 njerëzve ju ofron një mundësi të vetme që ta zbulojnë dhe të kënaqen me trashëgimin e begatshme natyrore evropiane.

Aktivitetet e këtilla rekreative janë në përputhje me dispozitat e Direktivave për vendbanime dhe shpendë, nëse të njëjtët nuk ndikojnë negativisht mbi vendbanimet dhe llojet e pranishme. Çelësi më shpesh fshihet në planifikimin dhe shfrytëzimin racional të resurseve, në mënyrë që nuk do të rrënohen vlerat që shërbejnë si bazë për ekzistimin e tyre.



Turneu me kajak me guidë në Parkun Nacional në Nuksio, si rajon Natura 2000 (Finlandë)

Zbatimi i Direktivave për vendbanime dhe shpendë dhe vendosja e rrjetës së rajoneve të Natura 2000 mbështetet mbi parimin e subsidiaritit, gjegjësisht, mbi parimin se çdo vend anëtar vendos vet për mënyrën më të përshtatshme për mbrojtjen e vlerave natyrore (të vendbanimeve dhe llojeve) në lokalitet të cilat janë me rëndësi për BE.

Planet për menaxhim janë vegël e dobishme me çka planifikohen aktivitetet që realizohen në rajon, me qëllim që i njëjti të ruhet në statusin e volitshëm të konzervimit sa u përket vendbanimeve dhe llojeve të rëndësishme për BE. Këto plane bëhen në përkim me nevojat e çdo rajoni të veçantë dhe japin mundësi për konsultime me palët e përfshira (organet e menaxhimit me rajonin e mbrojtur, vetëqeverisja lokale, organizatat joqeveritare, bashkësia lokale, etj.)



Dikustim për Planin për menaxhimin e rajonit potencial të Natura 2000 në Liqenin e Prespës (Maqedonia e Veriut)

Rajonet e Natura 2000 menaxhohen ose drejtohen sipas parimit të kryerjes së aktiviteteve tregtare në rajonet e mbrojtura pa u rrezikuar ekosistemet:

- PRANUESHMËRI – sistemi i rajoneve të mbrojtura parimisht nuk kundërshton kryerjen e aktiviteteve tregtare, por promovon zhvillim të drejtë të lokaliteteve të volitshme, kohës dhe shërbimeve.
- VËMENDJE – me rëndësi është që në kohë të kuptohen ndikimet e mundshme negative dhe të ndërmerren masa që të njëjtët të zvoglohen ose të menjanohen.
- PËRZGJEDHJE – aktivitetet e vetme që janë të ndaluar, ose të kufizuar, janë ata që mund të sjellin dëm mbi vlerat dhe objektet e mbrojtura.



Kositje në rajonin e Natura 2000, sipas Planit për menaxhim në rajonin e mbrojtur (Lituani)